

VENDIM
Nr. 151, datë 10.3.2021

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
RINDËRTIMIT TË ÇERDHE “VALIAS”, NË ZONËN E RE PËR ZHVILLIM TË
DETYRUAR, NË FSHATIN VALIAS, BASHKIA KAMZË, DHE CAKTIMIN E
BASHKISË KAMZË SI NJËSI ZBATUESE**
(ndryshuar me vendimin nr. 792, datë 12.12.2022)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në vlerën 82 267 780 (tetëdhjetë e dy milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH, për financimin e ndërtimit të çerdhes “Valias”, në zonën e re për zhvillim të detyruar, në fshatin Valias, Bashkia Kamzë.

2. Bashkisë Kamzë, në buxhetin e vitit 2021, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 16 453 556 (gjashtëmbëdhjetë milionë e katërqind e pesëdhjetë e tre mijë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, për financimin e ndërtimit të çerdhes “Valias”, në zonën e re për zhvillim të detyruar, në fshatin Valias, Bashkia Kamzë.

2/1. Bashkisë Kamzë, në buxhetin e vitit 2022, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 65 646 444 (gjashtëdhjetë e pesë milionë e gjashtëqind e dyzet e gjashtë mijë e katërqind e dyzet e katër) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të çerdhes në fshatin Valias, Bashkia Kamzë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022.

3. Caktimin e Bashkisë Kamzë si njësi zbatuese, sipas pikave 1 dhe 2 dhe 2/1 të këtij vendimi.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama